



RrGK bën thirrje për më shumë vëmendje ndaj nevojave të grave dhe burrave

Rrjeti i Grave të Kosovës shton perspektivën gjinore në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Në përputhje me raportin e Komisionit Evropian të vitit 2024 për Kosovën, RrGK dha komentin e saj për Programin e Integrimit Evropian të Kosovës për 2025-2029.

Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) është plani kryesor i Kosovës për reformat drejt anëtarësimit në BE. Ai synon përshtatjen e ligjeve vendase me ato të BE-së dhe është programi i tretë me këtë emër dhe i dhjeti që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

- Përfshirja e analizës gjinore në buxhetim për shërbime më të drejta socio-ekonomike për të përmbushur nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm në Kosovë.
- Zbatimi i skemës së punësimit të garantuar me masa afirmative për gratë, duke adresuar pjesëmarrjen e ulët të tyre në tregun e punës, ku vetëm 2 në 10 gra janë pjesëmarrëse në fuqinë punëtore.
- Rritja e pronësisë së grave për të lehtësuar qasjen në kredi dhe hapjen e bizneseve.
- Luftimi i ikjes nga tatimet me një qasje të përgjegjshme gjinore për të mbrojtur grupet më të cenueshme, apo siç e quajmë qasje 'mos bëj dëm' e cila është pjesë edhe e raportit tonë: Nën hije – Analiza gjinore e punës joformale në Kosovë
- Mbështetja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga Qendrat për Punë Sociale për të ndarë burime adekuatë dhe duke përfshirë punësimin e punonjësve socialë të specializuar në trajtimin e dhunës me bazë gjinore sipas Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
- Duke u zotuar qartë se sa qendra të tjera për kujdesin e fëmijëve do të hapë qeveria në mbarë Kosovën.



- Integrimi i perspektivës gjinore në ligje dhe politika publike përmes analizave të detyrueshme të ndikimit gjinor.



RrGK ka vërejtur se programi nuk ka tregues të qartë, synime të matshme dhe baza fillestare, gjë që e vështirëson matjen e progresit. Po ashtu, mungojnë objektivat për marrëdhëniet me fqinjët, bashkëpunimin rajonal dhe normalizimin Kosovë-Serbi, si dhe për zbatimin e Agjendës së BE për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Sugjerojmë përfshirjen e këtyre elementeve për një monitorim më të mirë dhe më shumë llogaridhënie në procesin e integritit.